



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Nr. 17 prill

KRYETARI
URDHËR

Dt. 03.01.2019

Nr 02 , datë 03 /01 /2019

Për inspektimin e territorit Bashkia Korçë në intervale të ndryshme kohore mbas orarit zyrtar si dhe ditët e Shtuna dhe të Diela me interval kohor të përditësuar duke filluar nga muaji Janar 2019 deri në daljen e një urdhëri të dytë.

Bazuar në pikat a) dhe b) të nenit 64 të ligjit nr.139/2015 datë 14.01.2016 “Për vetëqeverisjen vendore” ,të ligjit nr.9632,datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” ,të ndryshuar nenit 41 dhe 121 të ligjit nr.9632,datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe udhëzimit të ministrit të Financave nr.24, datë 02.09.2009 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar ,në nenin 8 të ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” të ndryshuar me ligjin nr.8835,datë 23.04.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8224,datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës”,ligji nr.10279,datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative si dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë nr.133,datë 14.11.2018 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2019 ”.

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës nga Drejtoria e Kontrollit Territorit (Sektori i Kontrollit jo Ushqimor dhe Liçensimit) .
2. Bazuar në detyrat funksionale të Drejtorisë të Kontrollit Territorit, grupi i punës i përmendur në pikën 1 të këtij urdhëri është përgjegjës për inspektimin, monitorimin dhe penalitetet:
 - a) Të mos lejohen të ushtrojnë veprimtari tregëtare në hapësirën publike të gjitha subjektet dhe individë pa lejen përkatëse nga Bashkia Korçë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - b) Inspektimi dhe monitorimi të kryhet në të gjitha subjektet që zhvillojnë aktivitetin në hapësirë publike me tavolina jashtë lokalit në zona historike Pazari i Vjetër dhe në gjithë territorin e qytetit Bashkia Korçë dhe në rastet e konstatimit të zbatohet procedura e penalitetit bazuar në legjislacioni në fuqi.
 - c) **Inspektimi dhe monitorimi të kryhet në të gjitha rastet të bazuara në VKB Nr.133 datë 14/11/2018 “Për nivelin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe penaliteteve për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2019.**
 - d) *Shfuqizimin e urdherit Nr.230 datë 17/04/2018 të Kryetarit të Bashkisë Korçë “Për inspektimin e territorit Bashkia Korçë në intervale të ndryshme kohore mbas orarit zyrtar si dhe ditët e Shtuna dhe të Diela me interval kohor të përditësuar duke filluar nga muaji Prill 2018 deri në daljen e një urdhëri të dytë ”.*
- Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore bazuar në Vendimi Nr. 511 datë 24/10/2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet Shtetërore ” Kreu I, pika 5 të përlllogaritë orët shtesë gjatë zbatimit të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi dhe Printoi dt:03.01.2019,ora 09¹³
Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit jo Ushqimor dhe Liçensimit
Lorenc PALODHI

KRYETARI

Sotirag FILO

